



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVES GJYKATA THEMELORE		REPUBLIKA KOSOVA OSNOVNI SUD
GJA-Su.A	58/24	
Dt:	19.01.2024	
PRISHTINE II PRISTINA		

GJA.nr.58/24

Dt.19.01.2024

Raporti i rregullt i punës

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

(Janar - Dhjetor 2023)

PËRMBAJTJE

HYRJE.....	3
Organizmi i Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj.....	3
Zyra e Kryetares.....	5
Në Zyrën e Ndërmjetësimit.....	6
Statistikat e lëndëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe dege.....	6
Zyra e Personelit.....	16
Zyra e Përkthimeve	16
Zyra e Financave	16
Zyra e Certifikimit.....	17
Zyra e Logjistikes.....	17
Zyra e Informimit Publik.....	18
Bashkëpunimi Me Organizatat Jo Qeveritare Dhe Qeveritare Ndërkombëtare dhe Vendore	19
Sidat me të cilat është ballafaquar Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë Vitit 2023	20

HYRJE

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nr. 06/L-054 dhe nenit 11 të Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023. Gjykata me Degët e gjykatës në Podujeve, Lipjan, Gllogoc dhe Graçanicë.

Ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës për vitin (Janar – Dhjetor) 2023, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore.

Në raport po ashtu përfshihet një pasqyrë e qartë për të gjitha kategoritë e lëndëve në gjykatë, kohëzgjatjen e zgjidhjes së lëndëve. Në raport përfshihen edhe të dhëna të tjera për kategoritë e ndryshme menaxheriale, administrative dhe profesionale për secilën degë të gjykatës, njësi – zyrë apo komisionin veç e veç, dhe një analizë e shkurtër për to. Të përfshira në raport janë edhe aktivitetet të cilat e kanë përcjell gjykatën, takimet e ndryshme që janë zhvilluar për këtë periudhë si dhe projektet e ndryshme të cilat janë duke u implementuar.

Organizmi i Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj

Gjykata Themelore e Prishtinës është njëra nga shtatë gjykatat themelore në Republikën e Kosovës.

Gjykata Themelore e Prishtinës është e organizuar dhe funksionin me seli në Prishtinë (Pallati i Drejtësisë, Objekti A dhe D) dhe vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Gllogovcit dhe të Graçanicës;

Gjykata Themelore e Prishtinës ka këto degë: Dega në Podujevë për komunën e Podujevës; dega në Graçanicë për komunën e Graçanicës; dega në Lipjan për komunën e Lipjanit; dega

në Gllogovc për komunën e Gllogovcit. dega në Fushë Kosovë për komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Obiliqi (nuk është funksionalizuar akoma).

Po ashtu, Gjykata Themelore e Prishtinës brenda saj ka tri Departamente të specializuara (Departamentin Special, Administrativ) me kompetence për tërë territorin e Kosovës.

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë të organizuara gjashtë (5) Departamente:

- Departamenti Special,
- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti Administrativ,
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilit funksionojnë

këto Divizione:

- Divizioni Penal
- Divizioni Civil dhe
- Divizioni për Kundërvajtje

Si një gjykatë e shkallës së parë, Gjykata Themelore e Prishtinës dhe katër degët e saj merren me të gjitha llojet e rasteve brenda territorit të komunave të lartcekura, si dhe për aktakuzat e Prokurorisë Speciale dhe lëndët administrative ka kompetence për krejt Kosovën).

Degët e gjykatës në Gllogovc, Graçanicë, Podujevë, Lipjan dhe Fushë Kosovë merren vetëm me rastet që bien në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm.

Aktualisht Gjykata Themelore në Prishtinë me degët në Podujeve, Lipjan, Gllogoc, Graçanicë dhe Fushë Kosovë ka të angazhuar gjithsejtë 109 gjyqtar, përfshirë këtu edhe kryetaren e gjykatës (prej tyre 99 janë aktiv, 5 janë në trajnim në Akademinë e Drejtësisë). Gjatë vitit 2023, janë pensionuar dy (2) gjyqtar dhe një (1) ka vdekur.

Gjykata Themelore në Prishtinë me degët e gjykatës në Podujeve, Lipjan, Gllogoc, Graçanicë dhe Fushë Kosovë përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës për vitin (janar – dhjetor) 2023, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore.

Zyra e Kryetares

Zyra e Kryetares së gjykatës gjatë periudhës raportuese të vitit 2023, ka përfunduar 141 kërkesa të autoriteteve të shteteve të ndryshme (Ndihme Juridike Ndërkombëtarë), 302 kërkesa për përjashtim të gjyqtareve, 121 kërkesa për lirim të parakohshëm me kolegji penal, zyra për rehabilitim ligjor dhe gjyqësore ka lëshuar 351 vërtetime për gjobe dhe vërejtje gjyqësore, 20 aktgjykime për bashkim të procedurës, janë kryer 121 aktvendime të cilat kenë qene kompetencë e Kryetares si dhe janë përfunduar 29.936 Ri-caktime të lëndëve përmes sistemit Smil.

Lidhur me procedurën disiplinore gjatë vitit 2023 nga palët janë pranuar 19 ankesa disiplinore ndaj gjyqtareve, përveç kësaj janë inicuar 2 hetime preliminare sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtareve, ndërsa të tjerat janë refuzuar si të pabazuara.

Zyra e kryetares dhe Zyra për Informim kanë trajtuar të gjitha kërkesat të cilat janë drejtuar në këtë zyre duke përfshirë edhe kërkesat e institucioneve publike, OJQ-ve dhe mediave. Me shkrim janë kthyer 932 përgjigje drejtuar këtyre institucioneve, janë trajtuar 118 kërkesa për qasje në dokumente publike, si dhe zyra për informim ka trajtuar çdo kërkesë që ka pasur për qëllim informata nga palët qofte përmes shkresave apo emailit.

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale, e cila menaxhohet nga zyra e kryetares në këtë periudhë raportuese ka trashëguara 1921 lëndë ndërsa janë pranuar 2436 lëndë të reja dhe kanë arrite të përfundohen apo ekzekutohen gjithsej 2571 lëndë, prej tyre 352 lëndë janë ekzekutuar me burgim efektiv, 27 lëndë janë parashkruar, me mënyrë tjetër si pagese e dënimit me gjobë, rigjykim, masa etj. janë ekzekutuar 2192 lëndë.

Në ekzekutimet civile gjate periudhës një vjeçare janë pranuar 2021 lende ndërsa janë ekzekutuar 1870 lëndë nga 5 referent ekzekutues, ndërsa ne divizionin e kundërvajtjes janë trashëguar 2278 janë pranuar 1203 lende dhe janë ekzekutuar 2038 lende nga 2 referent ekzekutues.

Gjykata Themelore ne Prishtine gjithashtu ka lëshuar 20.093 certifikata për verifikim të kaluarës kriminale dhe vula apostile.

1. Dega në Podujevë 8389

2. Dega në Lipjan 5289
3. Dega në Glllogoc 5655
4. Dega në Fushë Kosovë 539

Në Zyrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore Prishtinë referohen lëndë edhe nga degët e gjykatës, ku nga Tetori i vitit 2022, zyra e ndërmjetësimit me ndihmën e Usaid – Drejtësia Komerciale funksionin edhe ne degën e Lipjanit dhe Podujevës.

Ne zyrën e ndërmjetësimit në vitin 2023 nga muaji Janar deri ne fund të Dhjetorit janë referuar gjithsej 764 raste, prej te cilave 287 lëndë penale, 577 lëndë civile. Prej 287 lëndë penale, 241 kanë përfunduar të zgjidhura me marrëveshje të ndërmjetësimit ndërsa 20 kanë dështuar për tu zgjidhur në procedurë janë 26. Prej 577 lëndëve civile, 156 kanë përfunduar të zgjidhura me marrëveshje të ndërmjetësimit ndërsa 389 kanë dështuar për tu zgjidhur në procedurë janë 32. Gjithsej 397 lëndë të përfunduara me marrëveshje, ndërsa 409 lëndë të dështuara në ndërmjetësim. Në procedurë janë edhe 58 lëndë. Gjithsej janë 864 .

Dega ne Podujeve prej momentit të funksionalizimit të ndërmjetësimit ne ketë gjykate janë referuar gjithsej 57 lëndë penale prej të cilave janë kryer 45 lëndë penale ndërsa ndërmjetësimi ka dështuar në 7 lëndë.

Dega ne Lipjan gjatë vitit 2023 janë referuar gjithsej 43 lënde prej tyre 30 lënde janë zgjidhure ndërsa ndërmjetësimi ka dështuar në 11 lënde.

Statistikat e lëndëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe dege

Gjatë kësaj periudhe kohore Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Degët e saj kanë evidentuar në punë 44.371 lëndë gjyqësore, janë përfunduar 37.247 lëndë, ndërsa kanë mbetur të papërfunduara 92.439 lëndë.

Efikasiteti i Gjykata Themelore Prishtinë me dege për vitin 2023 është 83.94%.

Gjykata Themelore në Prishtinë

1.0 Departamenti Special

Në këtë departamenti gjatë vitit 2023 kanë qenë të trashëguara 103 lënde ndërsa janë pranuar 82 lënde gjithsej 185 lende dhe kanë arrite të përfundohen 60 lënde në punë ka 125 lëndë.

Ky departament ne vitin 2023 ka arrite efikasitet 73.17% krahas vitit 2022 ku ka pase efikasitetin 54.55% ndërsa ne vitin 2023 ka arrite ta ngris efikasitetin për 18.62%.

1.1 Departamentin e Krimeve të Rënda

Ne Departamentin e Krimeve të Rënda janë trashëguar 974 lënde gjatë vitit 2023 janë pranuar 306 lënde gjithsej 1280 ndërsa janë përfunduar 377 lënde kanë mbete në punë edhe 903 lende.

Ky departament ne vitin 2023 ka arrite efikasitet 123.20 krahas vitit 2022 ku ka pase efikasitetin 90.13% ndërsa ne vitin 2023 ka arrite ta ngris efikasitetin për 33.07% ku ka përfundu lende me shume se qe ka pranuar.

1.2 Departamenti për të Mitur

Departamenti për të Mitur ka trashëguar 539 lënde ka pranuar 382 lënde dhe ka përfunduar 498 lënde, në punë i ka të mbetura edhe 423 lënde. **Ky departament ne vitin 2023 ka arrite efikasitet 130.37 krahas vitit 2022 ku ka pase efikasitetin 112.86% ndërsa ne vitin 2023 ka arrite ta ngris efikasitetin për 17.51%.**

1.3 Departamenti për Çështje Administrative

Departamenti Administrativ ka trashëguar 5153 gjatë këtij viti ka pranuar 2418 lënde gjithsej 7571 ndërsa ka arritur të përfundoj 2557 lënde i kanë mbete në punë edhe 5014. **Ky departament ne vitin 2023 ka arrite efikasitet 105.75% krahas vitit 2022 ku ka pase efikasitetin 82.27% ndërsa ne vitin 2023 ka arrite ta ngris efikasitetin për 23.48%.**

1.4 Departamenti i përgjithshëm:

- Divizioni për Çështje Penale

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 13352 lënde, janë pranuar 5793 lënde ndërsa janë përfunduar 5647 lënde, kanë mbete në punë edhe 13498. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 97.48%.**

- Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil i cili është njëri ndër departamentet me të ngarkuara me lënde ka trashëguar 49.691 lënde, gjatë këtij viti ka pranuar 22.778 ndërsa ka përfunduar 15.422 (vlejnë të theksohet se ky departament ka arritur të zgjidhe 2.347 lënde me shume se në vitin 2022 ku kanë qenë të zgjidhura 13.075 lënde) dhe i kanë mbete në pune 57.047. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 76.70% krahas vitit 2022 ku ka pas efikasitet 64.34% ndërsa ne vitin 2023 ka arrit ta rris efikasitetin për 12.36%.**

- Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 14.647 lënde ndërsa janë pranuar 10.568 lënde gjithsej 25215 ndërsa janë përfunduar 10.972 lënde kanë mbete në punë edhe 14.243 lënde. **Ky departament ka arritur te ketë efikasitetin 103.82%.**

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Gjykata Themelore Prishtine - Deget

Perioda e raportimit: 01.01.2023 - 31.12.2023

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHEGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	418	1025	1443	836	607	81.56	233	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	13352	5793	19145	5647	13498	97.48	6,549	25
Krime të rënda Procedurë paraprake	213	620	833	522	311	84.19	60	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	974	306	1280	377	903	123.20	577	12
Penale të mitur procedura paraprake	90	123	213	112	101	91.06	55	
Penale të mitur Shqyrtim gjyqësor	539	382	921	498	423	130.37	179	3
Procedure Paraprake-Departamenti Special	135	276	411	244	167	88.41	31	
Shqyrtim gjyqësor-Departamenti Special	103	82	185	60	125	73.17	42	11
Kontestimore	39434	15515	54949	9431	45518	60.79	18,342	44
Jokontestimore	1283	825	2108	818	1290	99.15	556	
Permbartimore	8974	6438	15412	5173	10239	80.35	2,287	
Administrative	5153	2418	7571	2557	5014	105.75	1,545	8
Kundërvajtje	14647	10568	25215	10972	14243	103.82	1,103	4
Totali	85315	44371	129686	37247	92439	83.94	31,559	99

	LENDE TE TRASHEGUAR A TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Totali GJTHP- DEGET VITI 2022	85315	44371	129686	37247	92439	83.94%	31,559	
PRISHTINA	58244	27596	85840	22894	62946	82.96%	21887	
PODUJEVA	7106	4780	11886	4555	7331	95.29%	1759	
GRACANIC	2401	1256	3657	1089	2568	86.70%	807	
LIPJANE	8734	3766	12500	4734	7766	125.70%	3283	
GLLOGOC	5863	2865	8728	2751	5977	96.02%	2705	
FUSHE KOSOVE	2967	4108	7075	1224	5851	29.80%	1118	

Departamenti CIVIL	49691	22778	72469	15422	57047	76.70%	21185	
---------------------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	---------------	--------------	--

- Divizioni për Çështje Penale- Prishtinë

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 10.385 lënde, janë pranuar 3440 lënde ndërsa janë përfunduar 3733 lënde, kanë mbete në punë edhe 10.092. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 108.52% ku rezulton se ka arritur te përfundoj lende me shume se qe janë pranuar.**

Divizioni për Çështje Civile- Prishtinë

Departamenti civil ka trashëguar 31787 lende, gjate kësaj periudhe ka pranuar 14677 gjithsej ka 46464 ndërsa ka përfunduar 9341 lende ne pune i ka edhe 37123 lende. **Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 63.64%**

Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 8620 lënde ndërsa janë pranuar 4621 gjithsej 85840 lende ndërsa janë përfunduar 4951 lende kane mbete ne pune edhe 8290 lende. **Ky divizion ka arritur te ketë efikasitetin 107.14%.**

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Gjykata Themelore Prishtinë

Perioda e raportimit :01.01.2023 - 31.12.2023

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHËGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	245	651	896	499	397	76.65	136	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	10385	3440	13825	3733	10092	108.52	5443	16
Krime të rënda Procedurë paraprake	213	620	833	522	311	84.19	60	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	974	306	1280	377	903	123.20	577	12
Penale të mitur procedura paraprake	90	123	213	112	101	91.06	55	
Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor	539	382	921	498	423	130.37	179	3
Procedura Paraprake-Departamenti Special	135	276	411	244	167	88.41	31	
Shqyrtim gjyqësor-Departamenti Special	103	82	185	60	125	73.17	42	11
Kontestimore	26503	10088	36591	6256	30335	62.01	12459	31
Jokontestimore	579	298	877	344	533	115.44	238	
Permbarimore	4705	4291	8996	2741	6255	63.88	379	
Administrative	5153	2418	7571	2557	5014	105.75	1545	8
Kundërvajtje	8620	4621	13241	4951	8290	107.14	743	2
Totali	58244	27596	85840	22894	62946	82.96	21,887	83

2. Dega ne Podujevë

2.1 Divizioni për Çështje Penale

Në këtë departament janë trashëguar 394 lënde gjatë vitit 2023 janë pranuar 530 lënde ndërsa janë gjithsej 924 kane arrite te përfundohen 530 lënde dhe kanë mbetur në punë edhe 394 lënde.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 100.00%.

2.2 Divizioni për Çështje Civile

Departamenti civil ka trashëguar 4872 lende, gjate kësaj periudhe ka pranuar 2794 ndërsa ka përfunduar 2221 lende ndërsa ne pune i ka edhe 5445 lende.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 79.49% krahas vitit 2022 ku ka pas efikasitet 59.30% ne vitin 2023 ka arrite te rris efikasitetin për 20.19%

2.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 1819 lënde ndërsa janë pranuar 1348 lende gjithsej 3167 ndërsa janë përfunduar 1721 lende kane mbete ne pune edhe 1446 lende.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitetin 127.67% krahas viti 2022 ku ka pas efikasitet 84.24% dhe kete vite ka rrite efikasitetin për 43.43%.

Raport i përgjithshem për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Podujevë

Perioda e raportimit -01.01.2023 - 31.12.2023

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHEGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lendet ne pritje ne fund te periudhes raportuese me te vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	21	108	129	83	46	76.85	11	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	394	530	924	530	394	100.00	109	3
Kontestimore	4085	2061	6146	1373	4773	66.62	1432	3
Jokontestimore	67	127	194	100	94	78.74	26	
Permbarimore	720	606	1326	748	578	123.43	162	
Kundërvajtje	1819	1348	3167	1721	1446	127.67	19	1
Totali	7106	4780	11886	4555	7331	95.29	1,759	7

3. Dega ne Lipjan

3.1 Divizioni për Çështje Penale

Në divizionin penal janë trashëguar 946 lënde ndërsa janë pranuar 524 lënde gjithsej 1470 dhe kanë përfunduar 485 lënde në punë janë edhe 985 lënde.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 92.56%.

3.2 Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil i ka te trashëguara 5886 lende, është njeri ndër departamentet me të ngarkuara me lënde gjatë këtij viti ka pranuar 1686 ndërsa ka përfunduar 1847 lënde dhe në pune i ka 5725 lende.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 109.54% qe krahas viti 2022 ku ka pas efikasitet 61.19% kete vite ka rritur efikasitetin për 48.35%.

3.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjate vitit 2023 janë trashëguar 1820 lënde ndërsa janë pranuar 1441 lënde gjithsej 3261 lende të përfunduara 2264 lënde, kanë mbetë në punë edhe 997 lende.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitet 157.11%.

Raport i përgjithshem për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Lipjan

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHËGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	82	115	197	138	59	120.00	33	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	946	524	1470	485	985	92.56	316	3
Kontestimore	3220	1151	4371	1121	3250	97.39	1155	3
Jokontestimore	203	103	306	128	178	124.27	97	
Pembarimore	2463	432	2895	598	2297	138.43	1457	
Kundërvajtje	1820	1441	3261	2264	997	157.11	225	1
Totali	8734	3766	12500	4734	7766	125.70	3,283	7

4. Dega ne Gllgoc

4.1 Divizioni për Çështje Penale

Në divizionin penal janë trashëguar 214 lënde gjatë kësaj periudhe janë pranuar 398 lënde ndërsa janë përfunduar 387 lënde dhe në punë janë 225 lënde.

Divizioni penal ka arritur te ketë efikasitet 97.24%.

4.2 Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil ka trashëguar 4469 lënde, gjatë këtij viti ka pranuar 1479 ndërsa ka përfunduar 1328 dhe në pune i ka 4620 lënde. **Ky divizion ka arritur të ketë efikasitet 89.79% ku krahas viti 2022 qe ka pas efikasitet 69.88% ka arrit te rris efikasitetin për 19.91%**

4.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2023 janë trashëguar 1142 lënde, ndërsa janë pranuar 939 lënde ndërsa janë përfunduar 992 lënde, kanë mbete në punë edhe 1089 lende.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitet 105.64% ku krahas viti 2022 qe ka pas efikasitet 89.61% ketë vite ka rrite efikasitetin për 16.03%.

Raport i përgjithshem për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Gllgoc

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHËGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	38	49	87	44	43	89.80	34	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	214	398	612	387	225	97.24	84	1
Kontestimore	3458	528	3986	312	3674	59.09	2189	3
Jokontestimore	135	64	199	55	144	85.94	93	
Permbarimore	876	887	1763	961	802	108.34	238	
Kundërvajtje	1142	939	2081	992	1089	105.64	67	1
Totali	5863	2865	8728	2751	5977	96.02	2,705	5

5. Dega ne Graçanice

5.1 Divizioni për Çështje Penale

Në këtë divizion janë trashëguar 471 lende gjate kesaj periudhe jane pranuar 185 lende ndërsa janë përfunduar 171 lënde, në punë janë 485 lënde. **Efikasiteti për këtë departament është 92.43%.**

5.2 Divizioni për Çështje Civile

Në divizionin penal janë trashëguar 1202 gjatë kësaj periudhe janë pranuar 507 lënde ndërsa janë përfunduar 440 lënde në punë 1269 lënde. **Efikasiteti ka arritur në 86.78%.**

5.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjate vitit 2023 janë trashëguar 696 lënde ndërsa janë pranuar 523 lënde ndërsa janë përfunduar 457 lënde kanë mbete në punë edhe 762. **Ky divizion ka efikasitet 87.38%.**

Raport i përgjithshem për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Graçanica

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHEGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	32	41	73	21	52	51.22	19	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	471	185	656	171	485	92.43	198	1
Kontestimore	755	265	1020	197	823	74.34	397	2
Jokontestimore	277	162	439	176	263	108.64	100	
Permbarimore	170	80	250	67	183	83.75	44	
Kundërvajtje	696	523	1219	457	762	87.38	49	1
Totali	2401	1256	3657	1089	2568	86.70	807	4

6. Dega ne Fushë Kosovë

6.1 Divizioni për Çështje Penale

Në këtë divizion janë trashëguar 942 lende gjate kesaj periudhe janë pranuar 716 lende gjithsej 1658 lende ndërsa janë përfunduar 341 lënde, në punë janë 1317 lënde. **Efikasiteti për këtë departament është 47.63%.**

6.2 Divizioni për Çështje Civile

Në divizionin penal janë trashëguar 1475 gjatë kësaj periudhe janë pranuar 1635 lënde gjithsej 3110 lende ndërsa janë përfunduar 245 lënde në punë 2865 lënde. **Efikasiteti ka arritur në 14.98%.**

6.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjate vitit 2023 janë trashëguar 550 lënde ndërsa janë pranuar 1696 lënde gjithsej 2246 lende ndërsa janë përfunduar 587 lënde kanë mbete në punë edhe 1659 lende. **Ky divizion ka efikasitet 34.61%.**

Raport i përgjithshem për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Fushë Kosovë

DEPARTAMENTET	LENDE TE TRASHEGUARA TE VITIT 2022	LENDE TE PRANUARA TE VITI 2023	GJITHSEJ	LENDE TE ZGJIDHURA TE VITIT 2023	TE MBETURA 2023	EFIKASITETI	Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	0	61	61	51	10	83.61	0	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	942	716	1658	341	1317	47.63	399	1
Kontestimore	1413	1422	2835	172	2663	12.10	710	2
Jokontestimore	22	71	93	15	78	21.13	2	
Permbarimore	40	142	182	58	124	40.85	7	
Kundërvajtje	550	1696	2246	587	1659	34.61	0	1
Totali	2967	4108	7075	1224	5851	29.80	1,118	4

Zyra e Personelit

Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës raportuese të vitit 2023 ka publikuar konkursin për praktikant në periudhën një vjeçare nr.01/2023 më datë 03.02.2023 në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe degët e saj. Të shpallura gjithsejt 64 pozita, kjo procedurë e rekrutimit ka përfunduar me sukses dhe këta praktikant kanë filluar punën praktike me dt.13.03.2023.

Gjykata, gjithashtu ka publikuar konkursin e dyte për praktikant për periudhën një vjeçare nr.02/2023 më datë 03.10.2023 për Gjykatën Themelore Prishtinë dhe degën e gjykatës në Fushë Kosovë me gjithsej 46 pozita. Kandidatët e suksesshëm praktikën e kanë filluar më datë 24.10.2023.

Zyra e personelit gjithashtu mban evidencën lidhur me pushimet vjetore, mjekësore apo të lehonisë për gjyqtarët dhe stafin administrativ të gjykatës, menaxhon dhe kontrollon punën eventuale jashtë orarit dhe për këtë dërgon raportet në baza mujore në SKGJK për procesim në listën e pagave.

Në gjykatë kemi një zyrtare që merret me punët e personelit.

Zyra e Përkthimeve

Gjykata Themelore e Prishtinës vitin 2023 e ka filluar me 7 përkthyes të sistemuar me kontrata të rregullta dhe 3 me marrëveshje për shërbime të veçanta të financuar nga UNDP . Kjo situatë ka bërë që të normalizohet në masë të madhe gjendja me përkthime në gjykatë duke arritur që asnjë shkresë të mos pret për tu përkthyer. Përkthyesit me marrëveshje për shërbime të veçanta të financuar nga UNDP më 30 Shtator 2023 kanë përfunduar kontratën dhe nuk iu është vazhduar tutje më. Me funksionalizimin e degës së Gjykatës në Fushë Kosovë z. Edib Lutfiu kalon në pozitën e tij atje nga se me Aktemërim edhe ashtu ka qenë i caktuar për degën e Fushë Kosovës.

Aktualisht gjendja me përkthime është tejte e ngarkuar në gjykatë për shkak të shtimit në masë të madhe të seancave me nevojë për përkthim, sidomos në Departamentin Special.

Zyra e Financave

Zyra e Financave vepron sipas Ligjit të Financave Publike, Rregulloreve mbi Menaxhimin e Financave, Udhëzimeve Administrative aktuale që janë në fuqi. Siç dihet në procesin e Decentralizimit, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka pas të alokuar Buxhetin e vet sipas Programit të Kodit Organizativ 38100 dhe është përgjegjëse për shpenzimin e buxhetit në bazë të kërkesave të saj.

Gjithashtu vështirësi tjetër ka qenë mungesa e buxhetit nga muaji Qershor 2023 dhe nga kemi hasur në vonesa të pagesave sidomos për kategorinë e Shërbimeve të Përfaqësimit (avokat, ekspert dhe porot)

Buxheti i Gjykatës Themelore të Prishtinës është 896,175.00 € në kategorinë e Mallra dhe Shërbime, 65,500.00 € - për Shpenzime Komunale.

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë kanë arritur gjithsejtë të procesohen për pagesë deri më 31.12.2023 , 4917 fatura (të zotuar, të shpenzuara dhe të Certifikuara). në shumë prej 948,426.06 Euro

Mangësitë dhe vështirësitë në realizimin e detyrave është mungesa e buxhetit për realizimin e të gjitha kërkesave në Gjykatë dhe degët e saja.

Zyra e Certifikimit

Gjatë vitit- 2023 janë pranuar dhe janë kontrolluar aprovuar 4.912 pagesa për Avokat, Ekspert, Porote, Rryme, Telefon, Uji, Reprerentacion, Hapja dhe mbyllja P.G (Petikeshi), Biletat për dorëzues si dhe Shërbimet Postare.

Gjatë Vitit-2023 janë proceduar ne sistem Qertifikuar(Aprovuar) 4,912 pagesa ne vlerë prej 949,630.36€.

Pengesat e hasura gjate vitit-2023

Gjatë vitit - 2023 pengesat e hasura janë se lëndët te cilat janë sjelle për tu Qertifikuar(Aprovuar) ka pasur shumë lënde(Fatura) të cilat kanë qenë me vonesë qe kanë kaluar afatin ligjore ma shumë se (1) muaji.

Lëndët të cilat kanë pasë gabime teknike janë kthyer qe te permisohen apo te anulohen.

Zyra e Logjistikes

Gjykata Themelore Prishtinë në aspektin e logjistikës gjatë vitit 2023 gjendet në nivelin optimal, pasi që është furnizuar me materiale të ndryshëm zyrtar , material i shtypur, material hixhenik, dhe kompjuter të nevojshëm dhe të mjaftueshëm. Po ashtu është bërë plotësimi i kërkesave të stafit për furnizim me pajisje, inventar, pajisje të teknologjisë informative, menaxhimin e zyrave me inventar, vlerësimin e gjendjes së inventarit dhe pajisjeve nëpër zyrë.

Është bërë regjistrimi i inventarizimit të pasurisë jo financiare nga komisioni për inventarizim dhe komisioni për vlerësim të inventarit janë regjistruar për vitin 2023 gjithsej 6363 njësi në GjTh Prishtinë me degë, totali i vlerës monetare është 1,726.759.23€, është bërë vendosja e barcodeve për secilen njësi. Akomodimi i gjyqtareve në zyre, furnizim me inventar, furnizim me kompjuter dhe pajisjeve të tjera për zyrë të nevojshme dhe të mjaftueshëm.

Janë bërë të gjitha furnizimet sipas kërkesës, furnizimi me ujë të pijes, furnizim me derivate për ngrohje, furnizim me naftë për vetura. Gj.Th.Prishtinë me degët ka në shfrytëzim gjithësejt 14 vetura zyrtare, 6 vetura janë me qera nga AQP dhe 8 vetura janë pronë e SKGJK-së. Zbatimi i kërkesave dhe shpërndajë mallit sipas kërkesave të stafit të gjykatës, është bërë planifikimi dhe realizimi i planeve logjistike.

Menaxhimi i zyrave me inventar, vlerësimin e gjendjes së inventarit dhe pajisjeve nëpër zyre, ku ka qenë nevoja kemi bërë ndërrim. Regjistrimin dhe shifrimin e gjithë inventarit, barkodimi, transferim shënimeve të dorëzimit janë nënshkruar dhe mbushur në kontrollimin hyrës dhe dalës.

Përgatitja e raporteve të komisioneve dhe shpërndarja e materialit, regjistrimin e të gjitha hyrjeve dalje nga depo, analizimin e të dhënave për gjendjen e depos. Kërkesat për servisimin dhe mirëmbajtjen gjeneratorëve, servisimi dhe mirëmbajtja e kamerave, servisimin dhe mirëmbajtjen klimave, servisimi i ashensorëve në degët e gjykatës, servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT-se dhe servisimi dhe mirëmbajtja e veturave GjThP me degët Podujevë, Lipjan, Drenas dhe Graçanicë.

ZYRA E INFORMIMIT PUBLIK

Zyra për Informim Publik gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë informimin për aktivitetet dhe punët që janë kryer në gjykatë, ka mbajtur kontaktin me media duke dhënë informacione dhe njoftime për aktivitetet që zhvillohen brenda gjykatës, po ashtu është angazhuar për ngritjen e vetëdijësimin e opinionit publik duke ofruar informata rreth çështjeve të ndryshme në gjykatë, duke ndikuar në rritjen e besimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes dhënies së informacioneve të ndryshme rreth gjykatës. Komunikimi, transparencja dhe qasja e lehtë e qytetarëve në shërbimet e Gjykatës, ka qenë një prej prioriteteve të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Zyra për Informim Publik në këtë periudhë raportuese në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016), për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anonimizuara dhe së fundmi edhe të aktvendimeve, e që për këtë periudhë raportuese janë publikuar 3807 aktgjykime të anonimizuara në web-faqen e KGJK-së. Web-portali i gjyqësorit edhe këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës, me qëllim të informimit të tyre me kohë rreth aktiviteteve në Gjykatë, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve të formës së prerë, lajmërime publike si dhe informacione tjera të përditshme mbi veprimtarinë e Gjykatës.

Zyra për Informim Publik e kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe ka bërë hartimin e 86 komunikatave dhe përcjelljen e tyre tek mediat, monitorimin e mediave, përcjelljen e seancave gjyqësore, kthimin e përgjigjeve për mediat në koordinim me kryetaren e gjykatës, bashkëpunimin dhe kthimin e përgjigjeve në kërkesa të OJQ-ve të ndryshme, të cilat mbulojnë punën e gjykatave, sigurimin e qasjes së palëve, sigurimin e statistikave të ndryshme për rastet me interes për mediat, shoqërinë civile, studentët dhe qytetarët.

Zyra për Informim Publik e kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe po ashtu ka kryer përgjegjësitë e zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike, trajtimin e çdo kërkesë me shkrim dhe me email nga avokatë, media, OJQ dhe qytetarë duke krijuar sigurimin e qasjes, bazuar në kërkesat e tyre.

Bashkëpunimi me Organizatat Jo Qeveritare dhe Qeveritare Ndërkombëtare dhe Vendore

Gjatë vitit 2023, Programi Drejtësia komerciale në kuadër të Agjencisë për Zhvillim të SHBA (JSSP – USAID), ka vazhduar me angazhimin zyrtarëve ligjor për rritjen e efikasitetit në procedurën alternative të zgjidhjes së lëndëve me ndërmjetësim.

Gjithashtu përgjatë vitit 2023 UNDP ka vazhduar bashkëpunimin me Gjykatën Themelore të Prishtinës duke mbështetur gjykatën me 3 përkthyes me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta në afat të caktuar 6 mujor e cila ka përfunduar me 30 Shtator 2023, si dhe me 6 zyrtar për regjistrim dhe asgjësim të lëndëve të arkivuara të natyrës së kundërvajtjes.

Në bashkëpunim me IKD-në janë angazhuar dy zyrtar për anonimizim dhe publikim të vendimeve gjyqësore në gjuhën serbe,

Gjithashtu përgjatë vitit 2023 USAID me projektin drejtësia Komerciale, e ka mbështetur gjykatën me staf si dhe me dhënie të këshillave profesionale për avancimin e zyrës së

ndërmjetësimit, si dhe ka ndihmuar në funksionalizimin e zyrave të ndërmjetësimit në Lipjan dhe Podujevë.

Gjatë vitit 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degë ka vazhduar bashkëpunimin me USAID në kuadër të Projektit Drejtësia Procedurale, me qëllim të avancimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Me ndihmën e projektit CLARD dhe IKD gjatë këtij viti Gjykata Themelore në Prishtinë ka zhvilluar aktivitetin e “ Ditëve të Hapura të Gjykatës”, meqë rast janë zhvilluar takime me qytetarë në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët e saj.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur bashkëpunim me institucione, veprimtaria e të cilave mund të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik në përgjithësi në gjykatë, si Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale, Komuna e Prishtinës etj. Bashkëpunimi me institucionet tjera vendore, ndërkombëtare dhe shoqëritë civile ka vazhduar në kuadër të kompetencave që bartin dhe në respektim të memorandumeve të nënshkruara nga KGJK-ja.

Sidat me të cilat është ballafaquar Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë vitit 2023

Përkundër angazhimeve dhe të arriturave, gjykata gjatë vitit 2023 është ballafaquar edhe me sfida të ndryshme të cilat kanë frenuar arritjet edhe më të mëdha që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë synimi jonë.

Sfidat kryesore ka qenë, numri i madh i lëndëve dhe numri i vogël i gjyqtarëve, ku pothuajse secili departament dhe degë ndonjëra me pak e ndonjë më shumë është prek nga largimi i gjyqtareve në gjykata të shkalleve me të larta, pensionimi dhe arsyeja tjera çka realisht ka qenë sfide menaxhimi dhe shpërndarja e lëndëve tek gjyqtaret e tjerë dhe kjo patjetër që ka ndiku edhe në performancën e gjyqtareve në veçanti dhe gjykatës në tërësi. Po ashtu vazhdon me qenë sfide dhe me ndiku në statistika të përgjithshme numri i madh i lëndëve në ardhje, sidomos në civile dhe administrative. Si gjykata si pasoje e mungesës së gjyqtareve ka pas pengesa të mëdha në krijim të trupave gjyqësore. Kjo ngarkesë ka kërkuar angazhimin maksimal të gjyqtarëve, që pavarësisht faktit se janë zgjedhur në përbërje të trupave përkatëse, kryejnë detyrën edhe si pjesë e trupave të ndryshme gjyqësore.

Sfida më e madhe e Gjykatës ngelet numri tepër i madh i çështjeve të vjetra që presin për shqyrtimi (backlog), numri i madh i çështjeve të grumbulluar ndër vite në gjykatë mbetet një problem shqetësues dhe një sfidë për veprimtarinë e saj, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e procesit të administrimit të shpejtë dhe efektiv të drejtësisë. Ulja e numrit të lartë të çështjeve të vjetra kërkon kohë, por edhe një strategji koherente dhe frytdhënëse. Me qëllim të trajtimit të barabartë të palëve, gjyqtaret kanë vepruar sipas Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 dhe mendimeve të Këshillit të Etikes.

Sfide për gjyqësorin në përgjithësi, dhe këtu edhe për Gjykatën e Prishtinës, ka qenë sulmi i gjyqtareve, etiketimi dhe linçimi i tyre në raport me vendimet e marra. Pavarësia e gjyqësorit është lëkundur ndjeshëm në ketë vit nga një varg veprimesh të pushteteve tjera, qofte përmes kritikave, etiketimeve dhe përfoljes se gjyqtareve dhe familjareve të tyre, qofte duke u komentuar vendimet gjyqësore.

Andaj, vitit 2023 duhet të jetë i fokusuar më shumë kah obligimi që kemi për ti siguruar gjyqtaret me ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për siguri dhe mbrojtje të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2023 tepër shqetësuese ka qenë gjendja në Pallatin e Drejtësisë në kuptim të kushteve të punës, ku për shkak të mos funksionimit të sistemit të ajrosjes, si dhe sistemit të ftohjes dhe ngrohjes, kushtet e punës kane qenë shumë të rënuara, ku disa herë gjatë vitit jemi ballafaquar me alivanosje të stafit dhe të palëve për shkak të mungesës së ajrit të shëndetshëm në Pallat. Problem tjetër ka qenë defektet e kohëpaskohshme në ashensorët në objekte ku ka pas raste të shumta kur edhe janë ngujuar përdoruesit e ashensorëve brenda. Gjendja me ndriçim elektrik gjithashtu vazhdon me qenë problematike, pasi që nuk funksionin sistemi automatik i hapjes së ndriçimit elektrik për këtë arsye ndriçimi është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ku 24 orë dritat elektrike rrinë të ndezura. Nga hyrja në sezonin e dimrit, sistemi i ngrohjes nuk funksionin fare, zyrat janë duke u ngrohur me nxemje elektrike që i kanë siguruar vet punëtorët e Pallatit të Drejtësisë, çka gjykatës do ti kushtoj me fatura të larta të shpenzimit të energjisë elektrike.

Këto shqetësime vazhdimisht i kemi ngritur me shkrim në KGJK dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme si institucioni që ka nën mbikëqyrje objektet e institucioneve shtetërore.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani Rama
